



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2021:031861

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438882

P.nr.55/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurit K (A) M nga I.K-D, për shkak të dyshimit të bazuar të se ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par 9 lidhur me par 6 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, nr PP//II.nr.1363/2020, të dates 09.11.2020, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit te Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit, K. M, mbrojtësit të tij av. Isa Osdautaj, si dhe përfaqësuesi i viktimës M.Q pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 13.02.2024, shpalljen e aktgjykimit e bëri me dt. 14.02.2024 ndërsa me datë 12.03.2024, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

I pandehuri K (A) M i lindur më, në Gj, me vendbanim në fshatin I K-D, rr"U, tani me banim po aty, me numër, i biri i A, dhe nënës P, e gjinisë H, ,ka te kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor, i pa martuar, i nacionaliteti shqiptar, shtetas i Kosovës, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Me datën....., rreth orës .. minuta , në rrugën “S. D “K-D , nga pakujdesia ka shkelur ligjin për rregullat e trafikut rrugor, nga neni 41 par 1, në atë mënyrë që i pandehuri duke qarkulluar me veturën e tij të llojit “V”, me targa, nga drejtimi i qendrës së qytetit të Deçanit për në drejtim të fshatit B, ashtu që më të arritur me afërsi të shtëpisë së qytetarit Z. I, e duke mos i respektuar rregullat e trafikut rrugor , nuk e mban veturën në krahun e djathtë të lëvizjes por në një kthesë nga ana e djathtë kalon pjesërisht në anën e djathtë të rrugës e destinuar për lëvizje e mjeteve nga krahu i kundërt i lëvizjes , nga i cili drejtim qarkullonte motoçikleta “P” e tipit L të cilën në momentin kritik e drejtonte i dëmtuari I.Q, të cilin e godet me pjesën e parë ballore të anës së majtë , i cili si pasojë ndërron jetë në spitalin e Q në P, me datën në ora....

- Me çka ka kryer veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik “ nga neni 370 par 9 lidhur me par 6 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 40 par 3, 43 dhe 69 dhe 70 dhe nenit 370 lidhur me par 6 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tri (3) vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej tri (3) vite, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompensime të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, shpenzimet për ekspertizë mjeko ligjore 30 (tridhjetë) të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV. Udhëzohen e dëmtuara-përfaqësuesja ligjore A. Q, dhe M. Q nga fsh. C K. D, qe kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest civil

V. Dënim Plotësues i shqiptohet, të pandehurit K. M, konform nenit 59 par. 2 pika 2.5 të KPRK-së, i shqiptohet dënimi plotësues „Ndalimi i drejtimit të automjetit, për një (1) vit, pasi aktgjykimi të behët i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjën nr PP//II.nr.1363/2020 dates 19.02.2021 , kundër te pandehurit K(A) M nga fshati I. K-D, për shkak të dyshimit të bazuar të se ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 9 lidhur me par 6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 30.01.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, i akuzuari K. M, dhe mbrojtësi i tij av. Isa Osdautaj , pas konsultimit të mjaftueshëm me të pandehurin, i pandehuri është deklaruar i pa fajshëm.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri në seancën fillestare është deklaruar i pafajshëm.

Gjykata i njofton të pandehurin dhe mbrojtësin e tij, se kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimit të provave.

I pandehuri si dhe mbrojtësi i të pandehurit u deklarua se do të heqim dorë nga kërkesa për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave, ashtu qe kërkuan qe të kalohet në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me dt. 13.02.2024, caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor kryesor, në prezencë të prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të pandehurit K.M, mbrojtësit të tij av. Isa Osdautaj, përfaqësuesit të viktimës (djali i të ndjerit) M. Q.

Në fjalën hyrëse, prokurori i shtetit ka deklaruar se me akuzën me numër PP.nr,II, 1363/20 të datës 09.11.2020 i pandehuri K. M ngarkohet për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 9 lidhur me par 6 të KPRK-së të kryer siç përshkruhet në aktuzë.

Pretendimet akuzës do të vërtetohen gjatë seancave gjyqësore me provat që do të procedohet që kryesisht janë materialë si është ekspertizë e komunikacionit, punuar nga Ylli Koshi i cili ka konstatua që shkaktar i drejtpërdrejtë i aksidentit është drejtuesi i automjetit të markës V.. me targata të regjistrimit 03317 ch, i cili duhet mos e mbajtur krahun e djathtë të lëvizjes në një kthesë në të djathtë kalon me mjetin tij në anën e majtë të rrugës , ku si pasojë e godet ngasësin e motoçikletës duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse, po ashtu edhe sipas raportit të autopsisë MA202016, është konstatuar se vdekja ka ardhur si pasojë e lëndime të pësuar nga aksidenti i datës 30.07.2020, po ashtu edhe provat tjera të karakterit personal që i janë bashkëngjitur akuzës do të vërtetojnë në plotni pasi këtu të pandehurit për veprën penale për të cilën ngarkohet me akuzë.

Përfaqësuesi i palës: së dëmtuar M.Q deklaron fillimisht unë nuk kërkoj ndjeke penale për të pandehurin K. M po ashtu as kompensim dëmi nuk kërkojë. Duke e parë gjendjen e tij të rëndë shëndetësorë të ketë lehtësira nga ana e gjykatës .

Unë deklaroj se mesazhi i nënës time është burri më ka vdekur, aksidenti ka ndodh dhe dëshiron që këtij djali ti krijojë lehtësira pasi që është djali i ri dhe ka jetën përpara.

Eksperti i Nysret Pepa: deklaron i lartpërmenduri K. M, është i njohur për qendrën e shëndetit mendor pasi që është pacienti i kësaj qendre, si dhe i njëjti si në kohën ekspert vlerësimit ashtu edhe sipas bisedës së drejtpërdrejtë jemi të mendimit se është i vetëdijshëm i orientuar në kohën dhe hapësirë si dhe me personelin, e kupton

procedurën që zhvillohet ndaj tij, e kupton dhe kujton rastin që ka ndodhë, mund të bashkëpunojë me mbrojtësin e tij, si dhe e kupton masën që mund ti shqiptohet në procedurë.

I pandehuri K. M në fjalën hyrëse ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale, jam i penduar thellë, më vjen keq për rastin që më ka ndodhur, për këtë rast unë kam tentuar që të vras veten dhe i kam prere venat me dorën time, dhe nga ajo ditë jam i sëmurë.

Mbrojtësi i të pandehurit : Av. Isa Osdautaj ka deklaruar se meqenëse në seancën e sotme i pandehuri e pranon fajësinë , në përputhje me dispozitata ligjore njëherit në këtë seancë edhe një herë shpreh keqardhje për aksidentin e ndodhur, i shpreh ngushëllime familjes së të dëmtuarit I. Q, për vdekjen familjarit të tyre . Po ashtu në këtë seancë edhe prindi të pandehurit në mënyrë më të sinqerte i drejtohet palës së dëmtuar me fjalët i shprehi keqardhje e falënderon në pakufi .

Mendoje se kjo e vërtetë do të perceptohet drejtë nga ana e gjyqtarës prokurorit të çështjes , me që e pranoj fajësinë do të lëshohem në rrethanat lehtësuese lidhur me pranimin e fajësinë nga e pandehurit Kanun ashtu siç është paraqitur në dispozitiv të akuzës në mënyrë të veçante do e theksoj gjendjen e tij shëndetësore, emocionale të pandehurit Kanun, ku shihet drejtpërdrejtë ku edhe një gjendje tij shëndetësore u konstatuar nga ana e ekspertit shëndetësor , pos gjendjes së tij gjykata të merr parasysh se i njëjti deri më tani asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin , i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin në asnjë mënyrë , po ashtu duke pasur parasysh edhe moshën e tij të re , si dhe pendimin e thellë siç e ceka më lartë . Duke pasur parasysh këto rrethana dhe qëndrimin e pat ia ndaj veprimeve të tilla jam thellë i bindur se edhe me dënimin e shqiptuar me të butë do të arrihet qëllimi i dënimit të përcaktuar me ligj.

Andaj kërkoj nga gjykata që mbi bazën e këtyre të cekura më lartë e posaçërisht gjendjes së tij të rënduar shëndetësore të shqiptojë masën dënuese nen minimumin e paraparë ligjore, po ashtu ta lirojë nga shpenzimet e procedurës me qënë se jeta e tij personale ekonomike sociale është rënduar .

I pandehuri pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, në fjalën hyrëse u deklarua se e pranon fajësinë, për veprën penale që i vihet në barrë, ky pranim fajësie është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë.

Gjykata kërkoi nga prokurori i shtetit që të deklarohet rreth pranimit të fajësisë për të pandehurin.

Prokurori i Shtetit u deklarua se pasi që i pandehuri K. M e pranoi fajësisë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të tillë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresë të lënda. I propozoi gjykatës që të pranoi pranimin e fajësisë nga e të pandehurit për veprën penale që i vihet në barre, dhe me rastrin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Edhe mbrojtësi i të pandehurit av. I. O, ka deklaruar se pasi i pandehuri e bëri pranimin e fajësisë në fjalën hyrëse, se sa i përket rastit ka ndodhur me dt. 30.07.2020 në ora 10:40 siq përshkruhet në aktakuzë, ky rast ka ndodhur nga pakujdesia nga se viktimën dhe familjen e tij kurrë më parë nuk i ka njohur, por aksidenti ka ardhë pa dëshirën e të pandehurit Kanun, andaj e tërë kjo ka ndodhur nga pakujdesia dhe pa dashje.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në fjalën hyrëse në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 par. 1 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 9 lidhur me par 6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.1363/2020 dates 09.11.2020 në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjukata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, i njëjti ka shpreh shumë keqardhje, po ashtu si rrethanë lehtësuese muar se i pandehuri është në gjendje të rëndë shëndetësore, si dhe rrethanë posaçërisht lehtësuese muar se familjarët ia kanë falë sipas zakoneve, dhe se nuk kërkojnë ndjekje penale, por përfaqësuesi i viktimës M. Q, ka hjekë dorë edhe nga kompensimi i dëmit, eksperti i psikiatrisë në seancë ka deklaruar se e kupton masën që mund ti shqiptohet ku këtë fakt e kanë vërtetuar ekspertët e psikiatrisë ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale.

Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e po ashtu natyrën e veprës penale që është në rritje në shoqërinë tonë, dhe se në këtë rast pasoja është me fatalitet.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me gjobë të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe (për mundësinë që të kthehet në një element kontribues për vete, familjen dhe për rrethin ku jeton) të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Vendimi mbi shpenzimet u mor konform neni 453 par. 1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 357 par 2 dhe neni 365 dhe 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.55/2021 me datë 12.03.2024.

Zyrtare Ligjore
Liridona Palushi

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.